

Fakulteti: Fakulteti i shkencave sociale

Lënda: Lojërat dhe lodrat, Profesori lendes, Mr. Emrush Xhemajli

Njësia: Loja dhe lojërat, vështrim historik.

1. Hyrje

Historikisht, loja shfaqet me paraqitjen e punës njerëzore dhe të formave më primitive të artit. Në bashkësitë e para primitive shoqërore me shkallë të ulët të zhvillimit të fuqive dhe marrëdhënjeve prodhuese, fëmija në moshën më të hershme të tij futej në punën prodhuese me të rriturit. Secili fëmijë mësonte që sa më herët të mësojë për të punuar të gjitha punët që i punonin të rriturit dhe ë të fillojë nga fëmijëria e hershme për të marrë pjesë në të gjitha format e jetesës së të rriturve. **Në këtë bashkësi të parë shoqërore fëmijëria nuk ndahej si period e veçantë e zhvillimit të njeriut.** Prandaj, në këtë kohë historike as që kishte LOJËRA FËMIJËRORE ne kuptimin e sotëm të fjalës.

Loja e fëmijës paraqitet njëkohësisht me paraqitjen e nevojës për edukatë të posaçme të fëmijëve. **Pra loja dhe edukata që nga fillimi i tyre paraqiten bashkërisht** dhe paralelisht dhe ato mes veti gjithnjë qëndruan në lidhje të ngushtë duke u kushtëzuar reciprokisht njëra me tjetrën.

Me zhvillimin e mëtejshëm shoqëroro-ekonomik, si rezultat i ndërlikueshmërisë së mjeteve të prodhimit, të ndarjes së punës dhe të marrëdhënjeve prodhuese, fëmija nuk mundej të futej në punët prodhuese pa një parapërgatitje për punë. Prandaj, fëmijëria ndahej si një period e veçantë për t'u përgatitu për jetën e njeriut të rritur. Ata qysh si fëmijë filluan t'i përdorin modelet e zvogluara të vegalave të punës, modelet këto që në esencë ishin edhe lodrat e para të fëmijës.

Fëmija duke manipuluar me ato lodra gjatë aktiviteteve arriti që të luajë, dhe kështu paraqiten lojërat e para të fëmijës. Prandaj, **loja ka karakter shoqëror dhe historik.**

2. Mendimet dhe idetë e para mbi lojën

Idetë dhe mendimet e para mbi lojërat e fëmijëve i hasim qysh tek filozofët dhe pedagogët më të vjetër:

- a. **Platoni**¹ mendonte, se **për zhvillimin e fëmijës së vogël rol tejet të madh ka lëvizja.** Ai për zhvillimin e fëmijës në moshën 3-6 vjeçare lojën e konsideronte të pazëvendësueshme.
- b. **Aristoteli**², **jetoj ne Kohen ku shoqëria ndahej ne skllavopranërë e robër,** lojës i dha karakter klasor dhe **sipas tij LOJA I takon vëtëm njeriut të lire, don të thöë se jo edhe për robërit.**
- c. **Kontiliani**³ pedagog romak për lidhjen e punës me lojën ka thënë: **“Metodat e punës tek fëmijët duhet të zgjojnë interesimin e tyre dhe njehërit duhet të mbeten në paraqitjen e përjetimit të gëzimeve, argëtimit, lojës e këngës.**
- d. **Komenski**⁴ ishte pedagog çekqë u kushtoi rëndësi edukimit parashkollor të fëmijëve **“të mësuarit, patjetër duhet të paraqet gëzim”** thotë ai.
- e. **Pestaloci**⁵ pedagog i njohur zviceran që njihet për aplikimin e lojërave të fëmijëve në kopshtet parashkollore.

¹Platoni, filozof grek, i rrymes filozofike të idealizmit, i shek. 5-4 para eres sone (427-347), themelues i Shkolles së Athines.

²Aristoteli, filozof i Greqisë Antike, i rrymes filozofike të materializmit, i shekullit 4 (384-321) me origjinë ilire, mesues i Aleksandrit (Lekes së Madh).

³ Mark Fabie Kontiliani (42-118) pedagog romak

⁴ Jan Amos Komenski, (1592-1670) pedagog çek, që veprroi edhe në shumë vende të Europës.

⁵Henri Pestaloci 1746-1858) pedagog zviceran

- f. **Ushinski⁶, pedagog rus**,mjete kryesore educative i konsideron: krijimtarinë letarare e popullore, **lojërat, përrallat e përrallëzat**”
- g. **Robert Oueni,⁷ socialist utopist anglez**, i kushtoi rëndësi të vecantëzhvillimit të fëmijëve përmes lojërave. **Fëmijët në sistemin e edukimit parashkollor që e apolikoi Ai kohën më të madhe e kalonin në lojëra** që organizoheshin dhe që zhvilloheshin në fushat dhe hapsirat për lojëra.
- h. **Frebeli⁸**,pedagog gjerman, për zhvillimin e fëmijës, u kushtoi lojërave dhe lodrave, një rëndësi të jashtëzakonshme. Për ate **aizhilloi metodën e ”dhuratave lojë”⁹**.
- i. **Maria Montesori**, pedagoge, lojërat dhe lodrat i konsideronte të rëndesishme në punën me fëmijët parashkollorë si **“për zhvillimin e shqisave”** ashtu edhe për edukim e mësim.

⁶Konstantin Vishinski (1824-1870) pedagog rus

⁷ Robert Oueni (1771-1858) filantrop, sipërmarres dhe socialist utopist anglez

⁸ Fridrich Frebel 1782-1852) pedagog gjerman.

⁹ Lidhur me “dhuratat lojë” të Frobelit do të bëhet fjalë më detajisht kur të flitet për llojet e lojërave dhe llojet e lodrave.